Këshilli Komunal Për Siguri Në Bashkësi

OJQ "Syri i Vizionit"

Adresa: Qendra Zejtare 64/B; 30000 Pejë

Telefon: 039 423 240

E-mail: info@syriivizionit.org

www.syriivizionit.org

Projekti "Fuqizimi i këshillit komunal për siguri në bashkësi" ka filluar në Prill të vitit 2009, ku që dy vite është duke u implementuar nga OJQ "Syri i Vizionit", dhe mbështetur nga EWMI, dhe USAID. "Syri i Vizionit" në kuadër të projektit është koncentruar më shumë në monitorimin e punës së Shoqërisë civile në kuadër të projektit por edhe monitorimit të punës së KKSB-së.

Projekti ka për synim të ndihmojë në funksionalizimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB), në komunën e Pejës, kryesisht përmes kyçjes aktive të shoqërisë civile në këtë këshillë. Shoqëria civile ka luajtur një rolë të rëndësishëm edhe në themelimin të KKSB-së.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) - PEJË

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi si trup konsultues për çështje të sigurisë, është themeluar në qershor te vitit 2009, dhe mbanë takime të rregullta mujore ku diskuton për problematika të ndryshme që preokupojnë banorët e komunës së Pejës, pa dallime etnike e fetare.

Përkrahur nga:

EAST-WEST MANAGEMENT INSTITUTE

USAID NGA POPULLI AMERIKAN OD AMERIČKOG NARODA

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Fuqizimi i Këshillit Komunal Për Siguri Në Bashkësi Përmes Fuqizimit Të Shoqërisë Civile

Rithemelimi dhe Fuqizimi

Projekti ka për synim që të ndihmojë në funksionalizimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi(KKSB), në komunën e Pejës, kryesisht përmes kyçje aktive të shoqërisë civile në këtë këshillë.

Përfitues do të jetë Komuna, shoqëria civile përfaqësuesit e komuniteteve dhe të gjithë qytetarët, pasi këshilli do të ndihmojë në rritjen e sigurisë.

Gjatë këtyre muajve një person nga organizata jonë, ka përcjell përcjellë punën e këshillit, dhe vazhdimisht ka mbajtur takime të rregullta me OJQ-të për të mbledhur informata dhe për të ndikuar në agjendën e punës së KKSB-së.

Takimet kanë qenë javore me organizatat e shoqërisë civile që së bashku kanë identifikuar problematikat më të cilat përballen komunitetet në komunën e Pejës, duke i adresuar për trajtim brenda këshillit, që të gjejë zgjidhje dhe të krijojë siguri dhe mirëqenie më të mirë për qytetarët e Pejës.

Në kuadër të projektit janë mbajtur takime të rregullta me kryetarin e Komunës për rithemelimin e këshillit sipas udhëzimit administrativ.

Syri i Vizionit në bashkëpunim më Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe EWMI-në, kanë ofruar trajnime profesionale për anëtarët e KKSB-së duke ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të këshillit, hartimin e planit të punës dhe projekt propozimeve.

Projekti Fuqizimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përmes fuqizimit të shoqërisë civile ka filluar të implementohet në qershor të 2009 dhe do të përfundojë në fund të muajit korrik 2010. Projekti është mbështetur nga EWMI dhe USAID.

Qëllimi

Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi ka për qëllim:

1.1 Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike dhe rekomandimin e planeve të veprimit për t'i adresuar këto brenga në bashkëpunim me autoritetet komunale, komunitetet lokale dhe Policinë e Kosovës

1.2 Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve përmes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjedhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi.

Udhëzimi Administrativ

Çka është KKSB-ja?

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të një komune dhe përfaqësues të shoqërisë civile, siç është e përcaktuar në Nenin 7 të Ligjit për Policinë (Ligji Nr.03/L-035).

KKSB-ja është trup kryesor konsultues i komunës për çështjet e sigurisë, që në bashkëpunim më Policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për të gjitha bashkësitë në të mirë të të gjithë banorëve të komunës së Pejës.

Plani i Punës KKSB

1. Mirëmbajtja e rrugëve dhe kanaleve të hapura të qytetit.
2. Gripi i derrave dhe masat për parandalimin e tij.
3. Siguria në shkollat e mesme.
4. Vendosja dhe funksionimi i kamerave.
5. Lëvizja e nxënësve në trotuare.
6. Mbajtja e armëve pa leje dhe përdorimi i drogës.
7. Krimet Ekologjike.
8. Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve.
9. Parandalimi i zjarreve në fusha dhe pyje.
10. Largimi i lëmosh-kërkuesve nga rruga.
11. Siguria e personave me aftësi të kufizuar.
12. Parandalimi i kompanive private në gropimin e shtratit të lumenjve për zhavorr.
13. Siguria e rinisë në lokalet e natës (klubet, diskotekat).
14. Bashkëpunimi me EVSB, KLSP dhe OJQ.
15. Eliminimi i qenve endacakë
16. Shtimi i kontrollit të sigurisë rreth objekteve fetare.

Rezultatet e Arritura

* Përfshirja e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin komunal për siguri në bashkësi

* Bashkëpunimi më i madh në mes të institucioneve lokale, shoqërisë civile dhe komuniteteve

* Hartimi i planit të punës së institucioneve në bashkëpunim
me shoqërinë civile për përmirësimin e sigurisë

* Aprovimi i planit të punës nga kryetari i Komunës

* Harmonizimi i aktiviteteve veprues i përbashkët i institucioneve dhe shoqërisë civile në sigurinë e të gjitha qytetarëve